

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – SHËRBIME

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

- **Objekti i procedurës:** “Sigurimi i Pasurisë së Albcontrol”
- **Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP):** 98341140-8 Shërbime sigurimi, Shërbime të sigurimit të pronës 66515200 - 5.

Vlera e fondit limit: 79 946 666 (shtatëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e dyzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH**, ose **866 630.5** (tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tridhjetë pikë pesë) **Euro pa TVSH**. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën **27/08/2026** është **92.25 Lekë/Euro**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor ALBCONTROL SHA ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetë deklaratimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të V.K.M.-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, citohet: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i L.P.P. “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetë deklaratimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Ofertuesi duhet të jetë shoqëri sigurimesh, e cila të përmbushë të gjitha kërkesat e Legjislacionit të fushës, e pajisur me leje për ushtrim të aktivitetit sigurime dhe/ose risigurime nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF), ku të jenë specifikuar qartë grupet/klasat për sigurimet e kërkuara në këtë tender.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti operatori ekonomik duhet te paraqese Licencen “Per te ushtruar veprimtari sigurimi jo-jete, ne territorin e Republikes se Shqiperise” ku perfshihen Klasat 8 dhe 9, te leshuara nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (A.M.F.).

Përjashtohen nga kjo procedurë Brokerat dhe agjentet e sigurimeve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të L.P.P., nenit 41, pika 4/a, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 28, pika 2 e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me qëllim njohjen e të drejtës të subjektit për të kryer shërbime në ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit të jo-jetës në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe objektin e prokurimit.

2.1.2 Licenca profesionale dhe CV të stafit kryesor përgjegjës për zbatimin e kontratës:

Shoqëria e sigurimit duhet të ketë pjesë të stafit të saj vlerësues rrisht si dhe jo me pak se dy vlerësues demesh në sigurime të licencuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, sipas parashikimit të kuadrit ligjor në fuqi.

Për të vërtetuar këtë kriter Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtem:

a) Stafi kryesor përgjegjës për vlerësimin e rrisht, qe vertetohet me:

- CV te stafit kryesor per marrjen ne sigurim dhe vlerësimin e rrisht.

b) Stafi vlerësues demesh, qe vertetohet me:

- CV (curriculum Vitae);

- Kontratë pune (e vlefshme);

- Licencë e vlerësuesit të dëmit në sigurime (e vlefshme).

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të D.T. dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës (Sipas pikës 1 dhe pikës 6, të nenit 26, të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe nenit 41 të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të provojnë përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale objekt kontrate.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023,2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e L.P.P., si dhe nenin 43, të V.K.M. Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. V.K.M.-së nr.922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të balanceve të viteve: 2023, 2024, 2025 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të L.P.P., si dhe nenin 43, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, V.K.M. nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Janë vendosur kriteret e mësipërme, për të vërtetuar se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën me sukses.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe nenit 41, pika 3, të V.K.M. Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet "markë" përfshihet termi "ose ekuivalenti i tij/saj".

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Fondi limit dhe Specifikimet teknike janë hartuar nga dy grupe të posaçme, të cilat janë ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për përllogaritjen e fondit limit, si dhe hartimin e specifikimeve të teknike, në përputhje me nenet 4, pika 38/b, nenin 34 dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 1, dhe nenin 76 të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar në proporcion të drejtë me tipologjinë e shërbimit të kërkuar duke shprehur të dhënat minimale që duhen për realizimin me sukses të kontratës.

Termat e Referencës janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimin objekt procedure prokurimi, natyrën dhe afatin kohor për realizimin e këtij shërbimi si dhe bazuar në nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, në nenin 41/1 të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar.

Shënim: Përcaktimi i specifikimeve teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të L.P.P., si dhe nenit 41, pika 2, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të L.P.P.. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT